

MIRATOHET
KRYETARI BASHKISE LIBRAZHD
MARIGLEN DISHA

RELACION

MBI PROJEKT PREVENTIVIN

“SISTEMIM PERROI "SHEH"LIBRAZHD , MBROJTJE NGA GERRYERJET
DHE PERMBYTJET DHE REHABILITIM URBAN I ZONES PERRETH”

FAZA I-re
QYTETI LIBRAZHD

BASHKIA LIBRAZHD”

1. GJENDJA EKZISTUESE.
2. TE DHENA TOPOGRAFIKE DHE HIDROLOGJIKE
3. QELLIMI DHE OBJEKTIVAT E PROJEKTIT
4. NDIKIMI I PROJEKTIT NE MJEDIS
5. PARASHTRESE TEKNIKE E PROJEKTIT
6. SPECIFIKIME TEKNIKE
7. PREVENTIVI I PUNIMEVE
8. PROJEKTI I SISTEMIMIT TE PERROIT

1.GJENDJA EKZISTUESE

Perroi i Shese aktualisht ka nje shtrat te rrjedhjes prej 15 – 20 ml gjeresi .Ne te dy anet e perroit ka zona banimi te ndertuara si para viteve '90 (pallate 2 , 3 dhe 5 kateshe) si dhe ndertime prane shtratit te kryera pas viteve '90.

Popullsia qe banon ne keto zona eshte rreth 4000 banore.Ne krahun jugor te perroit (buze tij) eshte ndertuar tregu I qytetit te Librazhdit .

Aktualisht ne te derdhen ujrata e ndotura te disa objekteve te ketyre zonave te banimit , duke shkaktuar ndotje te ambientit sidomos ne periudhen e thate te veres ku edhe prurjet e perroit jane minimale .Ekziston nje projekt i ndertimit te sistemit te kanalizimeve te ujrave te ndotura per nje pjese te ketyre zonave ,i cili mund te vihet ne zbatim pas sistemimit te perroit.

2.TE DHENA TOPOGRAFIKE DHE HIDROLOGJIKE

Karakteristikat topografike

Perroi i Shese Librazhd

Ai buron ne faqen perendimore te masivit te malit te Shebenikut ne nje lartesi prej 2000 m dhe ka nje gjatesi prej 11 km,Siperfaqja e zones ujembledhese eshte e konsiderueshme me shpate qe shkojne ne 2 km gjeresi.

Kalon ne qytetin e Librazhdit ne nje gjatesi rreth 2 km, duke pershkuar zonat e banimit te njohura si ,zona tek ish reparti ushtarak,zona e banimit lagje e shese,zona e banimit prane tregut industrial e bujqesor,zona ish Volorekut ku bashkohet me lumin Skumbin.

Kuota fundore ku bashkohet me lumin Shkumbin eshte 240 m

Karakteristikat klimaterike dhe hidrologjike.

Klima eshte mesdhetare para-malore dhe malore

Temperatura mesatare eshte 14.5 grade Celsius,mesatarja e muajit me te ftohte eshte 5.5 grade Celsius dhe me ngrohte 24.5 grade Celsius.

Sasia mesatare e rreshjeve vjetore eshte 1364 mm nga te cilat pjesa me e madhe eshte ne stinen e dimrit.

Per perroit e shese nuk kemi te dhena specifike per sasine e prurjeve maksimale , minimale, mesatare , por jemi bazuar ne te dhenat e rreshjeve vjetore per rrethin e Librazhdit.

3.QELIMI DHE OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

Qellimi i Projektit

Eliminimi i demeve te shkaktuara ne zonen urbane nga rregjimi i pakontrolluar i rrjedhes se ujit pergjate shtratit te perroit

Ruajtja e mjedisit ,eliminimi i ndotjes se perroit te Shese dhe rrjedhimisht eliminimi i ndotjes se Lumit Shkumbin.

Objektivat qe mund te arrihen ne perfundim te projektit.

- Sistemohet rregjimi i rrjedhes se ujit duke ulur rrezikun e demeve nga erozioni shkaktuar nga prurjet e larta te ndodhura ne intervale kohe te herepashereshme, sidomos ne pranvere.
- Rehabilitohet shtrati i perroit, i demtuar nga vershimet dhe i degraduar nder vite.
- Permireson jeten e banoreve te qytetit.

4. NDIKIMI I PROJEKTIT NE MJEDIS

- Sigurohet nje mjedis ambietalisht i paster .
- Sigurohet nje pamje dhe mjedis relaksues pas nderhyrjeve ndertimore .

5.PARASHTRESE TEKNIKE E PROJEKTIT

Projekt –preventivi u hartua mbi bazen e :

- Gjendja ekzistuese e perroit.
- Trasimi i perroit.
- Zhvillimi i projektit.
- Projekti dhe preventivi.

Trasimi i perroit

Per sistemimin e perroit ne gjatesine 1.2 km si detyre e ketij projekti eshte perdoruar trasimi ne shkallen 1 : 1000 .

Pjeresia e shtratit te perroit varion sipas terrenit $i = 2.5 \%$, 3% dhe 3.5% . Keto pjerrsi do te perdoren edhe ne trasimin e ri te shtratit.

Ne trasimin e shtratit jane pasur parasysh keto kerkesa :

- Shtrati eshte trasuar i drejte ose trapezoidal , sipas terrenit duke ruajtur zhvillimet aktuale ne terren.
- Shtrati eshte trasuar me nje gjeresi te ndryshueshme sipas terrenit dhe lartesis se natyrore .
- Shtrati eshte trasuar ne kuotat me te uleta te tij, me nderhyrje te vogla
- Shtrati eshte trasuar per prurje maksimale ,por jo te jashtezakonshme.

Llogaritjet hidraulike , prurjes dhe dimensionimit.

Per llogaritjen e prurjeve me te cilen do te llogaritet aftesia transportuese dhe permasimi kanalit eshte patur parasysh prurja maksimale e llogaritur por edhe dimensionimi I veprave te artit ndertuar mbi kete shtrat, konkretisht 2 urat rrugore dhe ura hekurudhore.

$Q = q \cdot S$, ku S eshte siparfaqja ujembledhese e perroit te Shese dhe q eshte vlera llogaritese e hidromodulit per te.

Llogaritja e hidromodulit.

$$q = \frac{2.8 \cdot P \cdot \sqrt{2}}{t \cdot x \cdot \sqrt{S}}$$

q – hidromoduli I rrjedhjes

P- shirat ditore me perqindjen e sigurise se kerkuar ne mm

t – vazhdimesia e renies se shirave gjate dites ,ne ore

S – siperfaqja ujembledhese ne Ha

6– koeficienti I rrjedhjes (varet nga vetite e tokes dhe relieve I siperfaqe ujembledhese)

x- treguesi I fuqise (varet nga siperfaqja ujembledhese ,konfiguracioni dhe pjerresia).

Nga te dhenat ekzistuese kemi pjerresine e perroit $i = (2000-240)m/8.5 \text{ km} = 0.207 \text{ } ^{0/00}$

Per te bere llogaritjet pranohet $\sigma = 0.25$ per toka me pershkueshmeri mesatare dhe pjerresi te forte .

$p = 80 \text{ mm}$ marre nga "Shirat maksimale te Shqiperise" per 20 % siguri dhe me kohezgjatje 8 ore.

Nga tabela perkatese per te dhenat e perroit te Shese merret vlera e $x = 10$ (vlera maksimale)

Atehere llogaritet $Q = 25.8 \text{ m}^3/\text{s}$

Llogaritja e "kanalit"/shtratit

Llogaritja hidraulike e kanalit qendron ne gjetjen e e permasave te seksionit terthor te kanalit ne te cilin per pjerresine e dhene te fundit te kanalit dhe per lartesine e kerkuar te nivelit te ujit ne raport me buzen e kanalit ,te sigurohet kalimi neper kanal I prurjes llogaritese te percaktuar.

Llogaritja e kanalit eshte bere me formulen Shezi.

$$V = C \sqrt{R \cdot i}$$

Me llogaritjet hidraulike gjenden permasat e seksionit terthor te kanalit ne t cilin prurjet

llogaritese te jene te barabarte me prurjen e gjetur me formulen : $Q = V \cdot S = C \cdot \sqrt{R \cdot i} \cdot S$

Llogaritjet e kanalit jane bere njehkohesisht me ndertimin e profilin gjatesor .Gjate gjithë gjatesise se perroit nuk ka derdhje te tjera qe mund te shtojne prurjet e llogaritura.

Nisur nga konfiguracioni i perroit pranojme qe gjeresia e kanalit te jete minimalisht 10 ml, dhe maksimalisht 18 ml, duke ndryshuar lartesine e tij, ne baze edhe te terrenit dhe zhvillimeve ne territor.

Llogarisim lartesine h qe varion nga 3 m deri ne 4.5 m

5. SPECIFIKIME TEKNIKE

1. Kanali eshte projektuar me mure betonarme M 250 , dhe mure gabion me gure kave..

2. Gjatesia e perroit (mureve) qe do te sistemohet eshte 1200 ml ne total ,faza I-re 490 -500 ml
3. Gjeresia e mureve poshte/lart ,per muret beton eshte 120/ 50 cm, muret gabion 300/200
4. Siperfaqja e shtratit te Shejes qe do te sistemohet eshte 12,000 m²
5. Shtrati poshte i perroit ruhet ne gjendjen natyrore, me nderhyrje te vogla rehabilituese.
6. Ne projekt jane parashikuar qe punimet te kryhen ne prani te ujit, per shkak te punimve voluminoze qe kerkojne kohe te caktuar per realizimin e tyre

Nga perlogaritja e volumeve te punes si dhe ne zbatim te vendimeve ne fuqi per cmimet njesi te zerave te punes , preventivi per objektin "Sistemim perroi "Sheh" Librazhd, mbrojtje nga gerryerjet dhe permbytjet, dhe rehabilitim urban i zones perreth" Faza I-re, eshte
89,993,524 leke me tvsh

PUNOI

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT
SEKTORI PROJEKTEVE DHE INVESTIMEVE, ZBATIMIT TE KONTRATAVE
